



Datë: 07.05.2026

A.nr.185/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.185/2026 të datës 20.02.2026 të parashtruar nga ankuesi A.K, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr. 185/2026 e datës 20.02.2026 e parashtruar nga ankuesi A.K.

II. Obligohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, që ti ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për ndryshim të koeficientit për ankuesin, duke filluar nga data 16.10.2025 deri në ekzekutimin e këtij vendimi, ashtu që ankuesi të kompensohet me koeficientin e pagës GJ26/6.7 sipas akt emërimit me numër protokolli Nr.01-112-1375/2025 të nënshkruar me datë 16.10.2025.

III. Detyrohet Drejtori i Thesarit të Kosovës që të ndërmarr veprime për ekzekutimin e pagesës të bëjë kompensimin e ankuesit sipas koeficientit Gj25, sipas Akt emërimi me numër protokolli 02. Nr. 01-112-1375/2025, të datës 16.10.2025, pas pranimit të kërkesës si në piken II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi A.K (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 20.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se i njëjti mbanë pozitën e punës “Zyrtar i Lartë i Pasurisë” dhe paga nuk realizohet sipas aktit të emërimit i cili ja njeh të drejtën e koeficientit 6.7 po ashtu ankuesi kërkon që ti behet ekzekutimi i menjëhershëm i pagës në diferencën.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.02.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit më datë 20.02.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 885/2026 të datës 20.02.2026 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës; Përgjigjen e datës 16.02.2026; Emalin e datës 15.01.2026; Listën për ndryshimin e pagës të proceduar në Thesar; Konkursin e datës 07.07.2025; Listën e pagave të datës 27.10.2025; Akt emërimit me NR.01-112-1375/2025 të datës 16.10.2025; Kërkesën e datës 03.02.2026; Njoftimin përfundimtar të datës 11.09.2025; Listën e pagës për muajin Janar 2026; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Përgjigjen në ankesë të datës 27.02.2026; Kërkesën e datës 03.02.2026;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi është emëruar në pozitën “Zyrtar i Lartë i Pasurisë” sipas konkursit me numër të referencës RN00018161 të datës 07.07.2025, ndërsa me datë 16.10.2025 ankuesi ka nënshkruar aktin e emërimit me koeficient 6.7. Ankuesi nga themelimi i marrëdhënies së punës është paguar me koeficient 5 respektivisht sipas kategorisë profesionale 3, me datë 03.02.2026 ankuesi ka parashtruar kërkesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës që ti behet ndryshimi i koeficientit dhe të paguhet me koeficientin sipas aktit të emërimit 6.7. Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës me datë 16.02.2026 i është përgjigjur ankuesit se lënda e ankuesit është trajtuar nga organi i punësimit dhe e njëjta është proceduar në thesar për pagesë komform Aktit të emërimit.

Ankuesi në ankesën e datës 20.02.2026 të parashtruar në Këshill pretendon se i njëjti duhet ta realizoj pagën sipas aktit të emërimit i cili përcakton se paga baze për ankuesin duhet të jete GJ25 me koeficient 6.7 andaj edhe kërkon nga këshilli që ti aprovohet ankesa duke e obliguar organin kompetent që ta beje ekzekutimin e pagës sipas koeficientit si dhe ekzekutimin e menjëhershëm të diferencës së pa paguar nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me çështjen juridike administrative ju referuar edhe nenin 14, paragrafi 1,2,3 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku përcaktohet se; 1. Paga bazë e nëpunës/it civil është paga që përfiton nëpunësja/i civil për punën e kryer në një pozitë të caktuar

apo për një klasë të caktuar dhe korrespondon me punën e kryer brenda orarit të plotë të punës gjatë një (1) muaji.2. Paga bazë e nëpunëses/it civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcën Nr. 10 të këtij ligji. 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, andaj Kolegji i Këshillit konstaton se Komuna e Prishtinës, me datë 07.07.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00018161 për pozitën Zyrtar i Lartë i Pasurisë me koeficientin e pagës 6.2, sipas kategorisë profesionale, klasa profesional 1, e si rezultat i provave të lëndës, ankuesi ka rezultuar kandidati fitues, ndërsa Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, me datë 16.10.2025, ka lëshuar Akt Emërimit me numër protokolli Nr.01-112-1375/2025, ku ankuesi është caktuar në pozitën “Zyrtar i Lartë i Pasurisë”, në kategorinë profesional 1, klasa e pagës 6.7, mirëpo sipas provave të lëndës i njëjti nuk është paguar sipas pagës me koeficientin 6.7, mirëpo Komuna e Prishtinës sipas formularit për ndryshime të datës 03.11.2025, të datës 24.11.2025 dhe 15.01.2026, rezulton se ndryshimet janë përcjell me koeficientin 6.7, sipas rritjes së njëjesisë së koeficientit të përcaktuar me nenin 33 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin se ankuesi është emëruar në pozitën përkatëse sipas Akt Emërimit me numër protokolli Nr.01-112-1375/2025 të datës 16.10.2025, atëherë në rastin konkret aplikohet koeficienti 6.7 sipas ndryshimeve të përcaktuar me nenin 33 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në këtë rast bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se pas pranimi të këtij vendim organi i punësimit Komuna e Prishtinës që ta ri procedoj kërkesën për ndryshim të koeficientit për rastin e ankuesit tek Thesari i Kosovës dhe atë në mënyrë retroaktive nga koha e emërimit në pozitën sipas akt emërimit, ndërsa Drejtori i Thesarit të Kosovës, është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet për kompensimin e koeficientit sipas koeficientit të përcaktuar me ligj dhe me akt emërim.

Andaj duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.185/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.K;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.